

Vendim nr. 184 datë 18.09.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, në datën 18.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VASILLAQ KAÇKA**, përfaqësuar nga avokat Agron Lamaj, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 360, datë 04.11.2014 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2023-5557, datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 4/1, 6, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Vasillaq Kaçka (*kërkuesi*) dhe vëllai K.K. janë trashëgimtarët ligjorë të babait të tyre Ll.K. Nga ana tjetër, ky i fundit bashkë me vëllanë K.K. dhe dy motrat T.K. e A.K. janë trashëgimtarët ligjorë të babait të tyre S.K., ndërsa pas vdekjes ata kanë lënë trashëgimtarët përkatës.

2. Pas daljes së ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*ligji nr. 7698/1993*), trashëgimtarët e S.K. kanë kërkuar njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e disa pronave. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Pogradec (*KKKP, Pogradec*), me vendimin nr. 36, datë 28.12.1993 (*vendimi nr.36/1993*), ka vendosur njohjen e trashëgimtarëve të ish-pronarit S.K. pronarë të një sipërfaqe toke prej 2 484 m², të ndodhur në Pogradec, me kufij të përcaktuar.

3. Në vijim, mbi një kërkesë të trashëgimlënësit të kërkuesit, KKKP-ja, Pogradec, me vendimin nr. 36/1, datë 11.11.1994 (*vendimi nr.36/1/1994*), ka vendosur të njohë Ll.K. si ish-pronar të një sipërfaqeje toke prej 1 200 m², të ndodhur në Pogradec, me kufij të përcaktuar, duke i kthyer sipërfaqen 352 m² dhe e kompensuar për sipërfaqen e zënë prej 373 m², ndërkohë që pjesa tjetër, sipërfaqja prej 475 m², posedohej nga vetë ai dhe në të ka ndërtuar një banesë 2-katëshe.

4. Për pronën e njohur me këtë vendim të KKKP-së, Pogradec në favor të Ll.K., dy motrat e tij (T.K. e A.K.) kanë ngritur padi me objekt njohje bashkëpronësie, me pretendimin se prona është me trashëgim nga babai i tyre S.K. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, me vendimin nr. 1534, datë 07.12.1995, ka vendosur pranimin e padisë, duke njohur paditëset dhe trashëgimtarët e tjerë të S.K. si bashkëpronarë të pasurisë truall me sipërfaqe 1 200 m². Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2120, datë 13.03.1996, ndërsa Gjykata e Kasacionit, me vendimin 131, datë 29.01.1997, ka prishur vendimet e gjykatave më të ulëta duke e dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, për shkak se ka konstatuar shkelje në drejtim të formimit të trupit gjykues dhe njoftimit të të paditurit në gjykimin e çështjes në shkallë të parë. Nuk ka të dhëna për vijimin e këtij procesi gjyqësor dhe për ekzistencën e dosjes gjyqësore.

5. Vendimi nr. 36/1/1994 i KKKP-së, Pogradec, mbi padinë e trashëgimlënësit të kërkuesit Ll.K., është ndryshuar pjesërisht nga Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, me vendimin

nr. 1002, datë 17.05.2002, duke vendosur kthimin ish-pronarit edhe të sipërfaqes 153,3 m², vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Po ashtu, ky vendim i KKKP-së, Pogradec është kundërshtuar gjyqësisht edhe nga K.K, vëllai i Ll.K. dhe Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, me vendimin nr. 1111-1334, datë 24.12.2008, e ka ndryshuar pjesërisht atë duke njohur K.K. si bashkëpronar të pronës me sipërfaqe 1 200 m², si dhe posedimin edhe nga ai të sipërfaqes 475 m², vendim gjyqësor i cili edhe ky ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

6. Trashëgimlënësi i kërkuesit Ll.K. ka shitur, edhe vëllait K.K., një pjesë të sipërfaqes së kthyer me vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec, kurse për një pjesë tjetër të pronës vëllezërit Ll.K. dhe K.K. kanë lidhur kontrata sipërmarrjeje me shoqërinë “Konstruktion 93” sh.p.k., ndërsa kjo e fundit në vitin 2011 është pajisur me leje ndërtimi për një godinë banimi dhe ambiente shërbimi.

7. Në datën 17.01.2013 trashëgimtarët e motrave T.K. e A.K. kanë ngritur një padi kundër vëllait të tyre K.K. dhe trashëgimtarëve të vëllait tjetër Ll.K., ndër ata edhe kërkuesi, si dhe kundër shoqërisë “Konstruktion 93” sh.p.k. dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec. Përmes padisë është kërkuar: (i) njohja trashëgimtar i trashëgimlënësit S.K. dhe dorëzimi i pasurisë truall me sipërfaqe 1 200 m² dhe i frutave civile të nxjerra prej tij, sipas pjesëve takuese të trashëgimisë së S.K; (ii) fshirja e regjistrimit të pasurisë truall me sipërfaqe 1 200 m² në emër të të paditurve dhe regjistrimi i saj në emër të të gjithë trashëgimtarëve të të ndjerit S.K., sipas pjesëve takuese të trashëgimisë së tij. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec, me vendimin nr. (110)-51, datë 10.02.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Mbi ankimin e palës paditëse, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 360, datë 04.11.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar padinë. Për rekursin e të paditurve, përfshirë edhe të kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-5557, datë 25.10.2023, ka vendosur mospranimin e tyre.

8. Në datën 09.05.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 19.07.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkesit

9. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi vendimi i gjyqtarit relator në Gjykatën e Lartë për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sikundër edhe vendimi i datës 11.05.2023 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të tij të ndërmjetëm të datës 28.12.2015 dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh (*vendimi i revokimit*), nuk kanë asnjë bazë ligjore. Një vendim i tillë nuk përfshihet në kompetencën dhe në katalogun e vendimmarrjes së këtij kolegji, sipas nenit 485 të KPC-së. Edhe nëse do të pranohej se jemi para një interpretimi të normës, interpretimi i saj në rastin konkret është në kundërshtim me ligjin. Argumentet e atij kolegji se kemi të bëjmë me ndryshimet e fundit që ka pësuar legjislacioni procedural, si dhe në funksion të përmirësimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, do të thonë se kemi të bëjmë me një gjykim për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar, çka është në kompetencë të kolegjit të formuar nga 5 gjyqtarë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ai kolegji ka anashkaluar paragrafin 2 të dispozitës kalimtare të parashikuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 44/2021*) e cila shpreh qartë veprimin e ligjit në kohë, domethënë kompetencën e kolegjit vetëm për rekursin e pashqyrtuar, për të cilat do të zbatohet norma procedurale e kohës së depozitimit të rekursit dhe jo ajo e kohës së gjykimit.

9.1.2. *Parimit të legjitimitetit të palës që paraqet kërkesëpadinë*, pasi gjykata e apelit ka pranuar legjitimitetin aktiv të paditësve, në një kohë kur ata duhet të provonin marrëdhënien juridike nga buron e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i cenuar, personin i cili i ka cenuar në të drejtën e tyre, veprimet ose mosveprimet

e kundërligjshme, si dhe organin dhe mënyrën e rivendosjes së të drejtës së cenuar. Marrëdhënia juridike në rastin konkret sanksionohet nga ligji nr. 7698/1993, sipas të cilit prona fitohet vetëm në rrugë administrative nëpërmjet aktit përkatës të KKKP-së, prandaj paditësit duhet t'i ishin drejtuar KKKP-së për pretendimet e tyre dhe jo gjykatës, e cila nuk ka një kompetencë të tillë. Është i gabuar referimi i gjykatës së apelit në vendimin unifikues nr. 6/2007 të Gjykatës së Lartë, përveçse ajo ka ngatërruar të drejtat që rrjedhin nga pasuria trashëgimore me të drejtën e pronës private të fituar nga ligji. Moskuptimi i legjitimitetit dhe i natyrës së marrëdhënies juridike civile, përveçse e bën të parregullt procesin ligjor, i ka mohuar kërkuesit dhe të paditurve të tjerë të drejtën e pronës të fituar në mënyrë të ligjshme.

9.1.3. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar”* në lidhje me:

9.1.3.1. Vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të tij të datës 28.12.2015 për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa ai kolegji nuk ka marrë parasysh se ky i fundit është vendim i formës së prerë në kuptim të nenit 451 të KPC-së. Përmes këtij vendimi, kolegji ka pranuar se rekursi i kërkuesit ka shkaqe ligjore dhe për pasojë shqyrtimi i çështjes nuk mund të bëhet më në dhomën e këshillimit, por vetëm në seancë gjyqësore. Deri në revokimin e këtij vendimi, kërkuesi ka qenë në zotërim të një të drejte procedurale të fituar, atë të shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore, e drejtë e cila ka rëndësi për procesin e rregullt ligjor, sepse gjykimi në seancë gjyqësore zhvillohet sipas parimit të kontradiktoritetit dhe pala ka mundësi të dëgjohet dhe të parashtrijë mbrojtjen e saj.

9.1.3.2. Vendimin e marrë në procesin e parë gjyqësor të zhvilluar mes palëve, ndërsa gjykatat kanë shqyrtuar një mosmarrëveshje e cila është zgjidhur një herë me vendim të formës së prerë. Më herët trashëgimlënëset e paditësve kanë paraqitur një padi për njohjen bashkëpronare, gjykimi i së cilës ka përfunduar me vendimin nr. 131, datë 29.01.1997 të Gjykatës së

Kasacionit, me të cilin çështja është dërguar për rigjykim, ndërkohë që në dosje nuk është administruar asnjë provë nëse çështja është rigjykuar, fakt i cili duhet të ishte hetuar. Paditësit ishin të detyruar ose të vazhdonin procedurën e filluar, ose të kërkonin pushimin e gjykimit me heqje dorë, ndërkohë që gjykatat nuk mund të shqyrtonin të njëjtën mosmarrëveshje në një proces tjetër. Edhe nëse në rastin konkret nuk ndodhemi në kushtet e kuptimit klasik të “gjësë së gjykuar”, nuk mund të anashkalohet fakti se kërkuesi ndodhet përpara dy vendimeve të Gjykatës së Lartë që kanë disponuar në mënyrë të ndryshme për të drejtën e tij të pronësisë.

9.1.3.3. Vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec, ndërsa gjykatat nuk kanë pasur parasysh se ky vendim, referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*), barazohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Vendimet e ish-KKKP-ve, nëse nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, janë vlerësuar si vendime të formës së prerë, për rrjedhojë të ekzekutueshme dhe që nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces, as nga organet shtetërore, të çfarëdo natyre qofshin. Në rastin konkret, paditësit kanë shfaqur pretendime në lidhje me pronën e fituar nga të paditurit me vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec, por në asnjë rast ata nuk kanë ndjekur rrugën ligjore të kundërshtimit të këtij vendimi. Për rrjedhojë, ky vendim ka marrë formë të prerë në kuptim të nenit 451/a të KPC-së, duke përbërë “gjë të gjykuar” për sa i përket së drejtës së pronësisë së fituar nëpërmjet tij.

9.1.4. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme*, pasi në përbërjen e trupit gjykues të gjykatës së apelit kanë qenë edhe dy gjyqtarë, për të cilët kërkuesi ka kërkuar përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes, në kushtet kur ata kanë shprehur mendimin e tyre në dy gjykime të mëparshme. Kërkesa nuk është pranuar pavarësisht faktit se dy gjykimet ku ata gjyqtarë kishin marrë pjesë, kanë lidhje me objektin e gjykimit në rastin konkret. Po ashtu, ka një prezumim

ligjor se këta gjyqtarë janë larguar si të papërshtatshëm për sistemin e drejtësisë dhe sa kohë është ky prezumim, dyshimi dhe mosbesimi në dhënien e drejtësisë nga ata edhe në rastin në gjykim është plotësisht i ligjshëm.

9.1.5. *Së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes, pasi:*

9.1.5.1. Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin për seancën e datës 11.05.2023. Ai është njoftuar në datën 25.05.2023 për vendimin e Kolegjit Civil për revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe kthimin e saj për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 31.05.2023, ndërsa brenda 5 ditëve përpara seancës duhet të depozitonte pretendimet me shkrim. Meqenëse çështja ishte e vitit 2015, avokati i kërkuesit ka kërkuar të njihet me aktet e dosjes gjyqësore, por për shkak të pasaktësisë së numrit të çështjes të shpallur në listën e gjykimeve, sekretaria gjyqësore e ka njohur me vonesë me dosjen gjyqësore. Megjithatë, në datën 08.06.2023 ai ka depozituar parashtrimet me shkrim, por duke mos pasur kohën e duhur për një përgatitje të plotë, ndërsa ka pasur bindjen se seanca në dhomën e këshillimit ishte zhvilluar në datën 31.05.2023. Gjykata nuk e ka njoftuar për shtyrjen e kësaj seance, ashtu edhe të tre seancave të tjera më pas, ndërsa e ka njoftuar në datën 05.10.2023 për zhvillimin e seancës në datën 25.10.2023.

9.1.5.2. Gjykata e Lartë, duke mos i përmendur dhe pasqyruar në vendim, nuk ka marrë në shqyrtim dhe as ka arsyetuar në lidhje me pretendimet me shkrim të kërkuesit të datës 08.06.2023, të cilat në përmbajtjen e tyre kishin të bënin me elementet kryesore të një procesi të drejtë dhe të ligjshëm dhe arsyet e padrejtësisë së vendimit të gjykatës së apelit, duke qenë ato të ndryshme nga pretendimet e ngritura në rekursin e tij. Ajo gjykatë duhet të ishte shprehur për arsyet e mospranimit të tyre, për më tepër kur në to janë ngritur çështje të natyrës kushtetuese.

9.1.6. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi konkluzionet e Gjykatës së Lartë nuk bazohen në aktet ligjore dhe në parimet e rregullat që karakterizojnë*

mendimin e shëndoshë dhe logjik. Arsyetimi i vendimit të saj ka karakter empirik dhe subjektiv, ndërsa i mungon vlerësimi logjik i shkaqeve të rekursit. Ajo gjykatë ka “paragjykuar” drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit pa dhënë argumente që të çojnë në këtë përfundim, për më tepër kur në rastin konkret jemi para dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që japin përfundime të ndryshme për të njëjtat prova. Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte qëndrimin e kundërt për problemet ligjore që parashtrihen në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila e ka rrëzuar padinë për mungesë të legjitimitetit të paditësve, pra duke mos e shqyrtuar çështjen në themel, ku nisur nga kjo gjykata e apelit nuk mund të vendoste për themelin e çështjes. Edhe rrethanat e çështjes janë pasqyruar gabim në vendimin e asaj gjykate, ku për pasojë është krijuar një gjykim jo i vërtetë për objektin e padisë, sikur në rastin konkret kemi të bëjmë me pasuri trashëgimore dhe jo me një pronë private të fituar me vendim të KKKP-së. Në vendim arsyetohet se palët ndërgjyqëse janë trashëgimtarë të S.K., në një kohë kur trashëgimtarë të tij janë vetëm paditësit, ndërsa të paditurit janë trashëgimtarë të Ll.K. Vendimi i asaj gjykate ka edhe pasaktësi të tjera, duke paragjykuar përfundimin e çështjes.

- 9.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykata e apelit me procesin e zhvilluar ka krijuar një mënyrë të paligjshme të fitimit të së drejtës së pronësisë, atë nëpërmjet vendimit gjyqësor, ndërsa Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, e ka ligjëruar këtë padrejtësi duke i mohuar të drejtën e pronës, e cila është fituar në mënyrë të ligjshme në një nga format e parashikuara nga legjislati në fuqi dhe mbi bazën e një vendimi *quasi* gjyqësor të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitetin e kërkuar

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe

2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ai ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak që duhet të përmbushet për të vënë në lëvizje procesin kushtetues është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kërkuuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të gjykatës së apelit, në të cilën, sipas tij, kanë qenë edhe dy gjyqtarë, të cilët kanë shprehur mendimin e tyre për çështjen në dy gjykime të mëparshme, por pavarësisht kësaj kërkesa e tij për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes nuk

është pranuar. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në gjykimin e çështjes në apel kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e dy gjyqtarëve të trupit gjykues, kërkesë e cila është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues i gjykatës së apelit dhe me vendimin nr. 271 akti, datë 04.11.2014 është vendosur rrëzimi i saj, me arsyetimin se nuk rezultonte që gjyqtarët për të cilët kërkohej përjashtimi të kishin shprehur mendim për çështjen në gjykim, ndërsa natyra, objekti dhe palët në mosmarrëveshjen e mëparshme ishin të ndryshëm me ato të gjykimit në rastin konkret. Ky lloj vendimi, sipas nenit 75 të KPC-së, mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar. Ndërkohë, pas përfundimit të gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, ndërsa avokati i kërkuesit ka qenë prezent në shpalljen e vendimit, në datën 01.12.2014, brenda afatit ligjor 30-ditor, ai ka paraqitur rekurs kundër vendimit përfundimtar të saj. Megjithatë, në rekurs nuk janë parashtruar pretendime ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarëve të gjykatës së apelit. Mbi bazën edhe të rekursit të kërkuesit, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe gjatë shqyrtimit të saj, në datën 08.06.2023, kërkuesi ka paraqitur një parashtrësë me shkrim, në të cilën ka ngritur pretendime në drejtim të paanshmërisë së gjykatës së apelit për sa i përket përbërjes së trupit gjykues.

14. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” në lidhje me vendimin e marrë në procesin e parë gjyqësor të zhvilluar mes palëve. Sipas tij, mosmarrëveshja mes palëve është zgjidhur me vendim të formës së prerë, vendimin nr. 131, datë 29.01.1997 të Gjykatës së Kasacionit, me të cilin çështja është dërguar për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ndërkohë që në dosje nuk është administruar asnjë provë nëse çështja është rigjykuar, fakt i cili duhet të ishte hetuar. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në procesin e parë gjyqësor të vënë në lëvizje nga motrat e trashëgimlënësit të kërkuesit, me objekt njohjen bashkëpronarë mbi pronën e trajtuar në favorin e tij me vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec, sikurse është parashtruar në paragrafin 4 të këtij vendimi, pas pranimit të padisë nga gjykatat e faktit, Gjykata e Kasacionit, me vendimin 131, datë 29.01.1997, ka prishur vendimet e tyre duke e dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ndërkohë që nuk ka asnjë të dhënë për vijimin e këtij procesi gjyqësor dhe për ekzistencën e dosjes gjyqësore, çka nuk kontestohet as nga kërkuesi. Përtej kësaj, përgjatë gjithë procesit gjyqësor në shkallën e parë dhe

apel, sikundër edhe në rekurs, kërkuesi nuk ka ngritur asnjëherë pretendime të kësaj natyre, përveçse në parashtrësën e datës 08.06.2023 të paraqitur përpara Gjykatës së Lartë.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se dispozitat procedurale kanë parashikuar rekursin si mjetin e ankimit në Gjykatën e Lartë (neni 442 i KPC-së), afati ligjor i paraqitjes së të cilit është 30 ditë (neni 443 i KPC-së), afat i cili sipas ligjit procedural të kohës (neni 444 i KPC-së) fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Po ashtu, dispozitat procedurale parashikojnë se shkaqet e rekursit janë përcaktuese për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë (neni 473/a). Kjo nënkupton se kohëzgjatja e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë nuk nënkupton të drejtën e palës rekursuese, e cila e ka ushtruar të drejtën e saj në përputhje me afatet procedurale të ankimit, për të paraqitur pretendime ose shkaqe të reja për kundërshtimin e procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, të ndryshme apo përtej atyre të parashtruara në rekurs, pra nuk e rivendos atë palë në këtë të drejtë apo në afatin ligjor për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Ndërsa palës që paraqet rekurs i kërkohet të tregojë kujdesin e duhur, përmes përfaqësuesit ligjor, në paraqitjen e shkaqeve dhe pretendimeve në Gjykatën e Lartë. Paraqitja formalisht e kërkesave të reja në Gjykatën e Lartë, pavarësisht emërimit të tyre, nuk përbën një mjet të ri dhe për rrjedhojë nuk përfaqëson një mjet juridik të shteruar përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se për pretendimet e cenimit të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe të parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” në lidhje me vendimin e dhënë në procesin e parë gjyqësor mes palëve, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës.

17. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit në drejtim të cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në aspekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të parimit të legjitimitetit të palës që paraqet kërkesëpadinë, të parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” në lidhje me vendimin e revokimit të Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec, së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe të së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në thelb ato janë pretendime ndaj procesit

gjqësor të përmbyllur në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se për këto pretendime ai e ka përmbyllur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-5557, datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 09.05.2024. Nga komunikimi me Gjykatën e Lartë rezulton se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 23.02.2024, datë nga e cila palët mund ta dispononin atë. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj si rrjedhim ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

20. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi, në lidhje me vendimin e revokimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte. Në lidhje me vendimin e revokimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” dhe së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes.

21. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj me argumentin se vendimi i gjyqtarit relator të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sikundër edhe vendimi i datës 11.05.2023 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të tij të ndërmjetëm të datës 28.12.2015 dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh, nuk kanë asnjë bazë ligjore.

Një vendim i tillë, sipas kërkuetit, nuk përfshihet në kompetencën dhe në katalogun e vendimmarrjes së këtij kolegji, sipas nenit 485 të KPC-së. Edhe nëse do të pranohej se jemi para një interpretimi të normës, parashtron kërkueti, interpretimi i saj në rastin konkret është në kundërshtim me ligjin. Sipas tij, argumentet e atij kolegji se kemi të bëjmë me ndryshimet e fundit që ka pësuar legjislacioni procedural, si dhe në funksion të përmirësimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, do të thonë se kemi të bëjmë me një gjykim për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar, çka është në kompetencë të kolegjit të formuar nga 5 gjyqtarë ose të kolegeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ai kolegji, shprehet kërkueti, ka anashkaluar paragrafin 2 të dispozitës kalimtare të parashikuar me ligjin nr. 44/2021, e cila shpreh qartë veprimin e ligjit në kohë, domethënë kompetencën e kolegjit vetëm për rekursin e pashqyrtuar, për të cilat do të zbatohet norma procedurale e kohës së depozitimit të rekursit dhe jo ajo e kohës së gjykimit.

22. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar”, kërkueti ka argumentuar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të tij të datës 28.12.2015 për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore, nuk ka marrë parasysh se ky i fundit është vendim i formës së prerë në kuptim të nenit 451 të KPC-së. Përmes këtij vendimi, kolegji ka pranuar se rekursi ka shkaqe ligjore dhe për pasojë shqyrtimi i çështjes nuk mund të bëhet më në dhomën e këshillimit, por vetëm në seancë gjyqësore. Deri në revokimin e këtij vendimi, parashtron kërkueti, ai ka qenë në zotërim të një të drejte procedurale të fituar, atë të shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore, e drejtë e cila ka rëndësi për procesin e rregullt ligjor, sepse gjykimi në seancë gjyqësore zhvillohet sipas parimit të kontradiktoritetit dhe pala ka mundësi të dëgjohet dhe të parashtojë mbrojtjen e saj.

23. Ndërsa për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes, kërkueti ka argumentuar se është njoftuar në datën 25.05.2023 për vendimin e revokimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërsa brenda 5 ditëve përpara seancës në dhomën e këshillimit të datës 31.05.2023 mund të depozitonte pretendime me shkrim. Sipas tij, meqenëse çështja ishte e vitit 2015, avokati ka kërkuar të njihet me aktet e dosjes gjyqësore, por për shkak të pasaktësisë së numrit të çështjes të shpallur në listën e gjykimeve, sekretaria gjyqësore e ka njohur me vonesë me dosjen gjyqësore. Megjithatë, në datën 08.06.2023 ai ka depozituar parashtrimet me shkrim, por duke mos pasur kohën e duhur për një përgatitje të plotë, ndërsa ka pasur bindjen se

seanca në dhomën e këshillimit ishte zhvilluar në datën 31.05.2023. Në vijim, sipas kërkuessit, ai nuk është njoftuar për shtyrjen e kësaj seance, ashtu edhe të tre seancave të tjera më pas, ndërsa në datën 05.10.2023 ka marrë njoftim për zhvillimin e seancës në datën 25.10.2023.

24. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të theksojë fillimisht se ajo i shqyrton pretendimet më lart të kërkuessit në lidhje me vendimin e revokimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në këndvështrim të pretendimeve të tij për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në tërësinë e tij, në funksion të vlerësimit nëse ai ka qenë i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt.

25. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se çështja e kërkuessit është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 04.03.2015. Më herët, për kërkesën e kërkuessit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 29.12.2014, ka vendosur mospranimin e saj. Në vijim, ky kolegji, pas shqyrtimit seleksionues të rekurseve të paraqitura kundër vendimit të gjykatës së apelit, ndër të tjerë edhe nga kërkuessi, me vendimin e datës 28.12.2015 ka vendosur kalimin për gjykim të rekurseve, gjykim ky në seancë gjyqësore, i cili ka filluar në datën 22.06.2017, por nuk është zhvilluar për shkak të paraqitjes së një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve të trupit gjykues. Çështja ka mbetur pa u shqyrtuar deri kur Gjykata e Lartë ka rifilluar të funksionojë, ndërsa ajo është rindarë me short. Gjyqtari relator i çështjes ka nxjerrë vendimin për caktimin e datës për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit pikërisht për në datën 11.05.2023.

26. Në datën 11.05.2023 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, trupi gjykues i ngarkuar për shqyrtimin e çështjes, ka vendosur revokimin e vendimit të tij të ndërmjetëm të datës 28.12.2015 dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh, duke urdhëruar edhe njoftimin e palëve për këtë vendim dhe për të drejtën e tyre për të paraqitur parashtrime me shkrim deri 5 ditë përpara seancës në dhomën e këshillimit. Në vendimin e revokimit Kolegji Civil ka arsyetuar se sipas ndryshimeve të bëra në legjislacionin procedural (civil, administrativ dhe penal) me ligjet nr. 44/2021, nr. 49/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar dhe nr. 41/2021, datë 23.03.2021 “Për disa shtesa

dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 29.05.2021, janë përcaktuar disa rregullime praktike dhe efektive, në funksion të përmirësimit të gjyqimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, duke ripozicionuar natyrën e dhomës së këshillimit dhe përcaktuar një rol thelbësor të saj për shqyrtimin e çështjeve mbi bazë dokumentesh. Dispozitat tranzitore të këtyre ligjeve detyrojnë Gjykatën e Lartë të zbatojë rregullat e reja të gjyqimit dhe, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me ritin e gjyqimit të çështjeve në dhomën e këshillimit. Në këto kushte, për çështjet për të cilat më parë është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë gjyqësore, kolegji do të vlerësojë rast pas rasti nëse shkak i një vendimmarrjeje të tillë ka qenë nevoja për dëgjimin e palëve apo ato mund të shqyrtohen mbi bazë dokumentesh. Në rastin konkret, çështja është e tillë që mund të shqyrtohet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, mbi bazën e akteve, duke iu dhënë mundësia atyre të realizojnë mbrojtjen e interesave të veta, në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, përmes paraqitjes së parashtrimeve me shkrim.

27. Në datën 25.05.2023 kërkuesi dhe avokati i tij janë njoftuar rregullisht për vendimin e revokimit dhe për shqyrtimin e çështjes mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit të datës 31.05.2023, sikundër edhe për të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim. Përpara kësaj seance në dhomën e këshillimit, avokati i paditësve ka paraqitur kërkesë me shkrim për kalim procedural të të paditurit K.K., ndërsa ai kishte ndërruar jetë. Po ashtu, edhe avokati i kërkuetit ka paraqitur kërkesë me shkrim për shtyrjen e seancës në dhomën e këshillimit, duke parashtruar si shkak pamundësinë e paraqitjes së pretendimeve me shkrim për shkak të vënies me vonesë në dispozicion të dosjes gjyqësore nga sekretaria e gjykatës. Në këto kushte, seanca në dhomën e këshillimit është shtyrë dhe në datë 08.06.2023 avokati i kërkuetit ka depozituar pretendimet me shkrim në lidhje me rekursin e paraqitur. Vetëm pas kësaj kolegji ka caktuar seancën e radhës në dhomën e këshillimit për në datën 21.06.2023, duke publikuar në datën 09.06.2023 edhe njoftimin përkatës në këndin e afishimit dhe në faqen zyrtare të gjykatës. Megjithatë, kjo seancë në dhomën e këshillimit, sikundër edhe ato të planifikuara për në datat 5 dhe 12 korrik, nuk janë zhvilluar. Në datën 27.09.2023 kolegji ka marrë vendim për kalimin procedural të palëve përkatëse dhe në vijim ka caktuar datën 25.10.2023 për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit. Në datën 06.10.2023 avokati i kërkuetit është njoftuar rregullisht për seancën, ndërsa ai nuk ka paraqitur në

vijim ndonjë parashtresë tjetër me shkrim rreth rekursit. Në këtë seancë në dhomën e këshillimit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë vendimin përfundimtar, duke vendosur mospranimin edhe të rekursit të kërkuarit.

28. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i revokimit është marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, trupi gjykues i ngarkuar për shqyrtimin e çështjes dhe jo nga gjyqtari relator. Ky vendim është marrë në funksion të zhvillimit të gjykimit në atë gjykatë, ndërsa ai nuk është as përfundimtar, as jo përfundimtar, në kuptim të neneve 126 dhe 127 të këtij kodi dhe, për pasojë, nuk mund të trajtohet si vendim i formës së prerë në kuptim të nenit 451/a të tij. Vendimi në fjalë është marrë pas ndryshimeve që ka pësuar KPC-ja me ligjin nr. 44/2021, në dispozitën kalimtare të të cilit përcaktohet se procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, ndërkohë që në nenin 482, pika 1, të KPC-së përcaktohet se shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh, përveç rasteve të parashikuar në nenin 482/a të këtij kodi. Së fundi, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuari është njoftuar për vendimin e revokimit dhe shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sikundër edhe për datën e zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit, ndërsa atij i është dhënë mundësia dhe ai ka paraqitur parashtime me shkrim.

29. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë publike u përket vetë kolegjeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nisur nga sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në marrjen e vendimit të revokimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në rastin konkret ka vepruar në përputhje me parimin *tempus regit processum*, duke zbatuar legjislacionin procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit, që parashikon shqyrtimin e çështjeve, si rregull, në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh. Për sa i përket formës së gjykimit, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ajo ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, e cila vlerëson nëse në një çështje të caktuar ekziston ndonjë prej rasteve të parashikuara nga dispozitat e KPC-së për shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore në prani të palëve. Nga ana tjetër, forma e gjykimit të çështjes në seancë publike nuk përbën në vetvete një pritshmëri të ligjshme në kuptim të një të drejte procedurale, ndërkohë që forma e gjykimit të çështjes në rastin konkret, pra në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh, nuk provohet të ketë sjellë ndonjë pasojë në të drejtat e kërkuarit, për sa kohë ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrisë të drejtën e mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, qoftë nëpërmjet paraqitjes së rekursit, ashtu dhe përmes paraqitjes së parashtrimeve të tij me shkrim përpara zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit, duke i garantuar kërkuarit të drejtën e mbrojtjes, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt. Mbi këtë bazë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të pamjaftueshme argumentet e parashtruara nga kërkuari për të mbështetur pretendimet e tij për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes për sa i përket vendimit të revokimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndaj këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

31. Kërkuari ka pretenduar, po ashtu, cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes edhe me argumentin se Gjykata e Lartë, duke mos i përmendur dhe pasqyruar në vendim, nuk ka marrë në shqyrtim dhe as ka arsyetuar për pretendimet e tij me shkrim të datës 08.06.2023. Sipas kërkuarit, në përmbajtjen e tyre këto pretendime kanë të bëjnë me elementet kryesore të një procesi të drejtë dhe të ligjshëm dhe arsyet e padrejtësisë së vendimit të gjykatës së apelit, duke qenë ato të ndryshme nga pretendimet e ngritura në rekursin e tij. Ajo gjykatë, sipas tij, duhet të ishte shprehur për arsyet e mospranimin të tyre, për më tepër kur në ato janë ngritur

çështje të natyrës kushtetuese. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ky pretendim i kërkuesit është i lidhur me dy pretendimet e tjera të tij, atë për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në gjykatën e apelit dhe atë për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” për sa i përket vendimit të marrë në procesin e parë gjyqësor të zhvilluar mes palëve, ndërsa janë pikërisht këto pretendime të cilat janë ngritur në parashtresën e datës 08.06.2023 si pretendime të reja përtej atyre të parashtruara në rekurs. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton, po ashtu, se këto pretendime në parashtresën e kërkuesit nuk janë pasqyruar në vendimin e Gjykatës së Lartë.

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40 datë 22.12.2022; nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, interpretim sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (*shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se edhe pse në vendimin objekt kundërshtimi të Gjykatës së Lartë nuk pasqyrohen pretendimet e reja të ngritura nga kërkuesi në parashtresën e datës 08.06.2023 (ato në lidhje me paanësinë e gjykatës së apelit dhe sigurinë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” në lidhje me vendimin e marrë në procesin e parë gjyqësor të zhvilluar mes palëve), kjo përbën parregullsi jothelbësore. Ato pretendime janë ngritur dukshëm përtej afatit ligjor të rekursit, arsye për të cilën legjislacioni procedural parashikon se janë të

papranueshme. Nisur nga kjo, për sa kohë mospasqyrimi në vendimin e Gjykatës së Lartë i pretendimeve shtesë të kërkuarit nuk vërtetohet të ketë cenuar ndonjë të drejtë kushtetuese të tij, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes për sa i përket parashtrësës së tij të datës 08.06.2023, nuk përmban argumente të mjaftueshme që justifikojnë shqyrtimin në meritë të tij.

34. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të legjitimitetit të palës që paraqet kërkesëpadinë, si dhe të parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” për sa i përket vendimit nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara nga kërkuari në lidhje me këto pretendime, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ato kanë të bëjnë me qëndrimin e mbajtur nga gjykatat në vendimet objekt kundërshtimi, ndaj ato do të trajtohen në kuadër të pretendimit tjetër të kërkuarit, atij për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Po ashtu, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private, argumentet për të cilin janë të ndërvarura me atë për cenimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se çështja duhet të trajtohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë argumentet e paraqitura nga kërkuari, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson që pretendimet më lart të kërkuarit të trajtohen në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private

35. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e apelit ka pranuar legjitimitetin aktiv të paditësve në një kohë kur ata duhet të provonin marrëdhënien juridike nga buron e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i cenuar, personin i cili i ka cenuar në të drejtën e tyre, veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme, si dhe organin dhe mënyrën e rivendosjes së të drejtës së cenuar. Sipas tij, marrëdhënia juridike në rastin konkret sanksionohet nga ligji nr. 7698/1993, i cili ka rregulluar marrëdhënien juridike midis shtetit dhe ish-pronarëve, duke marrë përsipër kthimin atyre të pronave të marra në një nga mënyrat e parashikuara nga ai, përveçse me këtë ligj është ngritur dhe

një organ i posaçëm administrativ, veprimtaria e të cilit është konsideruar si një veprimtari me karakteristikat e një veprimtarie gjyqësore, duke pasur ky organ kompetencën për të vendosur për titullin e pronësisë, ndërkohë që vendimi i këtij organi mund të ankohej në gjykatë nga kushdo që kishte një interes të ligjshëm. Për rrjedhojë, sipas kërkuessit, për sa kohë prona sipas këtij ligji fitohet vetëm në rrugë administrative nëpërmjet aktit përkatës të KKKP-së, paditësit duhet t'i ishin drejtuar KKKP-së për pretendimet e tyre dhe jo gjykatës, e cila nuk ka një kompetencë të tillë. Po ashtu, sipas kërkuessit, është i gabuar referimi i gjykatës së apelit në vendimin unifikues nr. 6/2007 të Gjykatës së Lartë, përveçse ajo ka ngatërruar të drejtat që rrjedhin nga pasuria trashëgimore me të drejtën e pronës private të fituar nga ligji. Sipas tij, e drejta subjektive e pretenduar nga paditësit ka lidhje me faktin juridik të vdekjes së trashëgimlënësit të tyre S.K., por jo me pasurinë e një subjekti tjetër privat, çka është dhe arsyeja se pse paditësit nuk legjitimohen në padinë e tyre.

36. Kërkuessi, po ashtu, ka pretenduar se gjykatat nuk kanë pasur parasysh se vendimi nr. 36/1/1994 i KKKP-së, Pogradec, referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, barazohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Vendimet e ish-KKKP-ve, nëse nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, janë vlerësuar si vendime të formës së prerë, për rrjedhojë të ekzekutueshme dhe që nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces, as nga organet shtetërore, të çfarëdo natyre qofshin. Në rastin konkret, sipas kërkuessit, paditësit kanë shfaqur pretendime në lidhje me pronën e fituar nga të paditurit me vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, por në asnjë rast ata nuk kanë ndjekur rrugën ligjore të kundërshtimit të këtij vendimi. Për rrjedhojë, ky vendim ka marrë formë të prerë në kuptim të nenit 451/a të KPC-së, duke përbërë “gjë të gjykuar” për sa i përket së drejtës së pronësisë së fituar nëpërmjet tij.

37. Kërkuessi gjithashtu ka pretenduar se konkluzionet e Gjykatës së Lartë nuk bazohen në aktet ligjore dhe në parimet e rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë dhe logjik. Arsyetimi i vendimit të saj, sipas kërkuessit, ka karakter empirik dhe subjektiv, ndërsa i mungon vlerësimi logjik i shkaqeve të rekursit. Ajo gjykatë, shprehet kërkuessi, ka “paragjykuar” drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit pa dhënë argumente që të çojnë në këtë përfundim, për më tepër kur në rastin konkret jemi para dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që japin përfundime të ndryshme për të njëjtat prova. Sipas kërkuessit, Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte qëndrimin e kundërt për problemet ligjore që parashtrohen në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila e

ka rrëzuar padinë për mungesë të legjitimitit të paditësve, pra duke mos e shqyrtuar çështjen në themel, ku nisur nga kjo gjykata e apelit nuk mund të vendoste për themelin e çështjes. Edhe rrethanat e çështjes, sipas tij, janë pasqyruar gabim në vendimin e asaj gjykate, ku për pasojë është krijuar një gjykim jo i vërtetë për objektin e padisë, sikur në rastin konkret kemi të bëjmë me pasuri trashëgimore dhe jo me një pronë private të fituar me vendim të KKKP-së. Në vendim, parashtron kërkuesi, arsyetohet se palët ndërgjyqëse janë trashëgimtarë të S.K., në një kohë kur trashëgimtarë të tij janë vetëm paditësit, ndërsa të paditurit janë trashëgimtarë të Ll.K. Vendimi i asaj gjykate ka edhe pasaktësi të tjera, duke paragjykuar përfundimin e çështjes.

38. Së fundi, kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit me procesin e zhvilluar ka krijuar një mënyrë të paligjshme të fitimit të së drejtës së pronësisë, atë nëpërmjet vendimit gjyqësor, ndërsa Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, e ka ligjëruar këtë padrejtësi duke i mohuar të drejtën e pronës, e cila është fituar në mënyrë të ligjshme në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe mbi bazën e një vendimi *quasi* gjyqësor të formës së prerë.

39. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 12, datë 28.02.2024; nr.12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pretendimet e kërkuarit duhet t'i nënshtrohen analizës për të vlerësuar nëse gjykata e apelit ka përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të saj për çështjet e faktit dhe të ligjit të shtruara për diskutim përpara saj dhe në veçanti në lidhje me legjitimitimin aktiv të paditësve. Dhe po ashtu, për të vlerësuar nëse arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë është logjik, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje dhe respekton rregullat e mendimit të drejtë, si dhe nëse arsyetimi i kufizuar i saj cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Së fundi, për të vlerësuar nëse nga ato gjykata ka ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë.

43. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se gjykata e shkallës së parë është vënë në lëvizje me një padi përmes të cilës është kërkuar: (i) njohja trashëgimtar i

trashëgimlënësit S.K. dhe dorëzimi i pasurisë truall me sipërfaqe 1 200 m² dhe i frutave civile të nxjerra prej tij, sipas pjesëve takuese të trashëgimisë; (ii) fshirja e regjistrit të pasurisë truall me sipërfaqe 1 200 m² në emër të të paditurve dhe regjistrimi i saj në emër të të gjithë trashëgimtarëve të të ndjerit S.K., sipas pjesëve takuese të trashëgimisë së tij. Sipas paditësve, pasuria truall me sipërfaqe 1 200 m², e njohur dhe kthyer ish-pronarit me vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së Pogradec ka qenë në pronësi të trashëgimlënësit të palëve ndërgjyqëse S.K., ndaj të gjithë trashëgimtarët e tij dhe jo vetëm të paditurit tërheqin të drejta mbi këtë pasuri dhe frutat civile të saj. Nga ana tjetër, të paditurit kanë prapësuar se pasuria objekt padie ka qenë pronë e tyre dhe jo e trashëgimlënësit S.K., që u është njohur dhe kthyer me vendim të KKKP-së, Pogradec dhe vendimet gjyqësore përkatëse ndaj paditësit nuk tërheqin asnjë të drejtë mbi atë pasuri dhe frutat civile të saj.

44. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se paditësit nuk kanë kundërshtuar në rrugë administrative vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec apo ta kenë bërë objekt konflikti gjyqësor pretendimin e tyre për ndryshimin e tij për sa i përket ish-pronarit, për të cilin ata pretendojnë se është i ndjeri S.K. Po ashtu, sipas asaj gjykate, paditësit nuk provojnë se pasuria objekt gjykimi ka qenë në pronësi të të ndjerit S.K., ndërsa ata nuk kanë paraqitur asnjë provë për mënyrën se si ky i fundit e ka fituar pronësinë, ndërkohë që në dokumentet arkivore të vitit 1951 (*sipas vërtetimit nr. 220/1, datë 30.08.1993 të Degës së Arkivit Shtetëror Pogradec*) pasuria figuron e regjistruar në emër të djalit të tij Ll.K., i cili ka qenë madhor dhe gëzonte zotësinë juridike për të qenë pronar i saj. Së fundi, sipas asaj gjykate, një pretendim bashkëpronësie rrjedhur nga trashëgimi, mbi bazën e origjinës së pasurisë në emër të gjyshit të përbashkët, është një çështje provueshmërie nga pala që ngre pretendimin dhe nuk përbën prezumim ligjor për një bashkëpronësi të tillë vetëm fakti i qenies trashëgimtar apo jetesa në të njëjtin trung familjar, për më tepër kur kjo nuk mund të provojë të kundërtën e të dhënave të pasqyruara në regjistrat kadastralë (*vërtetimi arkivor i sipërpërmendur*).

45. Mbi ankimin e paditësve, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar padinë e tyre. Në vendimin e saj gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një analizë të saktë, tërësore dhe objektive të provave në lidhje me pretendimin e paditësve për bashkëpronësinë, ndërsa e ka bazuar vendimin vetëm në një nga provat

e administruara në gjykim (sipas vërtetimit nr. 220/1, datë 30.08.1993 të Degës së Arkivit Shtetëror Pogradec), provë të cilën nuk e ka vlerësuar drejt. Nga ana tjetër, sipas gjykatës së apelit, nga provat e administruara në gjykim rezultonte se pasuria e njohur dhe kthyer me vendimin nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec ka qenë pronë e të ndjerit S.K. dhe për pasojë përfitues të saj janë të gjithë ndërgjyqësit në këtë gjykim, si trashëgimtarë të tij. Gjykata e apelit ka arsyetuar se vetëm shënimi i emrit të Ll.K. në listat e pronësisë tokësore të qytetit të Pogradecit në vitin 1951, nuk e bën atë pronar të pasurisë, për sa kohë nuk provohej fitimi i saj prej tij, ndërkohë që një shënim i tillë në ato dokumente është bërë sipas ligjit të kohës (dekretit nr. 1182, datë 27.11.1950 “Për shërbimin kadastral” dhe rregullores së dalë në zbatim të tij), ndërsa ai ka mbetur kryefamiljar si fëmija më i madh në familje pas vdekjes së babait S.K. në vitin 1950. Gjykata e apelit ka vërejtur se nuk ka asnjë të dhënë që Ll.K. të ketë qenë pronar përpara reformës agrare të vitit 1945, ndryshe nga sa rezulton për babanë e tij S.K., ndërkohë që për shkak të moshës, por edhe të ligjit të kohës (ligjit nr. 108, datë 29.08.1945 “Për reformën agrare”) që ndalonte tjetërsimin e tokave bujqësore, Ll.K. nuk mund të fitonte pronësinë për pasurinë objekt gjykimi. Po ashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar se njohja e bashkëpronësisë që vjen nga trashëgimi nuk kërkon ndjekjen e ndonjë procedure administrative, ndaj paditësit nuk kishin arsye të kundërshtonin në rrugë administrative vendimin nr. 36/1/1004 të KKKP-së, Pogradec, vendim përmes të cilit, referuar edhe vendimit unifikues nr. 6/2007 të Gjykatës së Lartë, shteti ka përmbushur detyrimin për njohjen dhe kthimin e pronës në favor të ish-pronarit, jo vetëm kundrejt një prej trashëgimtarëve të tij, por për të gjithë ata që tërheqin të drejta nga trashëgimi.

46. Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, Kolegji Civil i saj ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit. Në vendimin e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit ka respektuar ato norma procedurale, të cilat mund të çonin në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor apo të procedurës së gjykimit, përveçse nuk rezultonin shkelje të rënda procedurale prej saj, të cilat mund të kishin ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Po ashtu, sipas atij kolegji, palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar

të gjitha parimet bazë të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu, sipas atij kolegj, gjykata e apelit ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, duke kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndërkohë që vendimi i saj nuk vjen në kundërshtim me praktikën e atij kolegji apo kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë.

47. Në analizë të vendimeve objekt kundërshtimi, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se gjykata e apelit ka përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të saj për çështjet e faktit dhe të ligjit të shtruara për diskutim përpara saj, duke arsyetuar edhe në drejtim të legjitimitetit aktiv të paditësve, ndërsa ka pranuar se pasuria objekt gjykimi ka qenë pronë e trashëgimlënësit S.K. dhe për pasojë ata tërheqin të drejta mbi të, duke pasur kështu interes të ligjshëm për kërkimin e saj. Vlen të theksohet se edhe gjykata e shkallës së parë nuk rezulton të jetë shprehur për mungesën e legjitimitetit të paditësve, ndërsa ajo e ka rrëzuar padinë në themel, duke vlerësuar se ata nuk kanë vërtetuar në gjykim të drejtën e pretenduar të (bashkë)pronësisë së ardhur nga trashëgimi. Po ashtu, për rrëzimin e padisë ajo ka përdorur si argument edhe mospërdorimin nga paditësit të mjetit ligjor të duhur, atë të kundërshtimit në rrugë administrative të vendimit nr. 36/1/1994 të KKKP-së, Pogradec apo në rrugë gjyqësore, duke nënkuptuar me këtë mungesën e një kërkimi në padi për ndryshimin e këtij vendimi. Ndërkohë, gjykata e apelit i ka trajtuar të dyja këto çështje, duke analizuar dhe parashtruar në vendimin e saj argumentet përkatëse dhe përfundimet e arritura prej saj për çështje të faktit dhe të ligjit.

48. Për sa i përket vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ky vendim, megjithëse me arsyetim të kufizuar, përmban të dhënat e palëve, objektin e gjykimit, mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe arsyetimin e përmbledhur të gjykatave më të ulëta, shkaqet dhe argumentet e paraqitura në rekurs, përfshirë edhe në atë të kërkuesit, ligjin e zbatueshëm, si dhe vlerësimin e asaj gjykate për shkaqet e rekursit në raport me procesin e zhvilluar në gjykatat më të ulëta dhe, në veçanti, në gjykatën e apelit. Arsyetimi i vendimit nuk rezulton të jetë alogjik, i paqartë dhe kontradiktor në përmbajtje dhe të mos respektojë rregullat e mendimit të drejtë, ndërkohë që pjesa arsyetuese lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv.

49. Së fundi, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se nuk rezulton që nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë të ketë ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik, sa një gjykatë e arsyeshme

nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë dhe të ishte i tillë që ta bënte gjykimin të padrejtë, duke theksuar se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, gjë e cila është detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

50. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private, të analizuara në këndvështrim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, janë haptazi të pabazuara.

51. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket kërkuetit Vasillaq Kaçka, me objekt: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 360, datë 04.11.2014 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2023-5557, datë 25.10.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, ne, gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji, jemi kundër qëndrimit të shumicës për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi vlerësojmë se kërkesa përmbush kriteret paraprake të pranueshmërisë, përfshirë legjitimitimin *ratione materiae*.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes, rezulton se kërkueti është palë e paditur në një proces gjyqësor me objekt njohjen trashëgimtar të trashëgimlënësit S.K., dorëzimin e pasurisë truall dhe frutave civile të nxjerra prej saj, si dhe fshirjen e regjistrimit të pasurisë truall në emër të të paditurve në gjykim dhe regjistrimin në emër të të gjithë trashëgimtarëve sipas pjesëve takuese. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, ndërsa gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar padinë. Për rekursin e kërkuetit (dhe paditësve të tjerë në gjykim), me vendimin e datës 28.12.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore. Pas pothuajse 8 vjetësh, Kolegji Civil, i formuar prej tre gjyqtarëve të tjerë, me vendimin e datës 11.05.2023, ka vendosur revokimin e vendimit të ndërmjetëm dhe, në vijim, në datën 25.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit.

3. Kërkueti në lidhje me revokimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike në drejtim të “gjësë së gjykuar” dhe së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes. Këto pretendime të kërkuetit shumica ka vlerësuar t’i analizojë të ndërlidhura me pretendimet për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në tërësinë e tij, në funksion të vlerësimit nëse ai ka qenë i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

4. Gjatë vlerësimit, shumica ka evidentuar disa fakte: (i) kërkueti dhe avokati i tij janë njoftuar rregullisht për vendimin e revokimit dhe për shqyrtimin e çështjes mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, si dhe për të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim;

(ii) Gjykata e Lartë i ka shtyrë disa herë seancat e planifikuara për shqyrtimin e rekursit për të realizuar kalimin procedural të palëve në proces; (iii) avokati i kërkuarit ka depozituar pretendimet me shkrim në lidhje me rekursin e paraqitur; (iv) në seancën e datës 25.10.2023, në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë vendimin përfundimtar, duke vendosur mospranimin edhe të rekursit të kërkuarit (*shih paragrafin 27 të vendimit*).

5. Duke i analizuar pretendimet e kërkuarit sipas fakteve të evidentuara, shumica ka vlerësuar se në marrjen e vendimit të revokimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me parimin *tempus regit processum*, duke zbatuar legjislacionin procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të rekursit, që parashikon shqyrtimin e çështjeve, si rregull, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve. Sipas shumicës, forma e gjykimit të çështjes në seancë publike nuk përbën në vetvete një pritshmëri të ligjshme në kuptim të një të drejte procedurale dhe kërkuarit nuk i ka ardhur asnjë pasojë për sa kohë ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrisë të drejtën e mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar. Në përfundim, shumica ka çmuar si të pamjaftueshme argumentet e parashtruara nga kërkuari për të mbështetur pretendimet e tij për vendimin e revokimit të kalimit të çështjes në seancë nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 30 të vendimit*).

6. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmojmë se argumentet e parashtruara nga kërkuari nuk mund të konsiderohen haptazi të pabazuara në fazën e shqyrtimit paraprak të çështjes, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, përkundrazi, argumentet janë të mjaftueshme që pretendimin e kërkuarit ta ngrenë në nivel kushtetues, sepse vënë në diskutim standardet kushtetuese të parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

7. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe

që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në jurisprudencën e Gjykatës, në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është bërë ndarja e qartë mes juridiksionit dhe kompetencave të dhomës së këshillimit dhe asaj të seancës (*shih vendimin nr. 17, datë 18.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Kështu, si në lidhje me shqyrtimin e rekursit ose të kërkesës për rishikim, Gjykata është shprehur për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e tyre, ajo luan rolin e një filtri për kërkesat që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 26, datë 27.03.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në kohën e paraqitjes së rekursit prej kërkuarit dhe kur Gjykata e Lartë vendosi kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore, ligji procedural civil parashikonte se në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë verifikoheshin vetëm kriteret formale të rekursit, ndërsa gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore shqyrtohej themeli i shkaqeve të rekursit, pra bazueshmëria ligjore e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara. Në kohën kur Gjykata e Lartë vendosi revokimin e vendimit të ndërmjetëm, ligji procedural civil kishte pësuar ndryshime me ligjet nr. 38/2017 dhe nr. 44/2021, sipas të cilave Gjykata e Lartë shqyrton në dhomën e këshillimit jo vetëm kriteret formale të rekursit, por edhe themelin e shkaqeve të ngritura në recurs (nenet 482, 482/a dhe 485 të KPC-së).

10. Në këtë pikëpamje, për të vlerësuar respektimin e gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të procedurës dhe kompetencave, në rastin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë është e rëndësishme të evidentohet se shqyrtimi i rekursit ndjek dy faza procedurale të ndryshme, në të cilat kompetencat e kolegjeve janë të ndryshme: (i) faza e shqyrtimit paraprak, procedurë e cila zhvillohet gjithnjë në dhomën e këshillimit dhe kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë ushtrohen *de plano*, pasi

lidhen me seleksionimin e rekurseve të suksesshme; (ii) faza e shqyrtimit të themelit të shkaqeve të rekursit, procedurë e cila sipas natyrës së çështjes dhe në diskrecion të Kolegjit të Gjykatës së Lartë mund të zhvillohet në dhomën e këshillimit ose në seancë me pjesëmarrjen e palëve, ku kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë lidhen me themelin e shkaqeve të rekursit rreth çështjeve të kuptimit të ligjit, sipas hipotezave të detajuara në ligjet procedurale.

11. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, rezulton se me vendimin e ndërmjetëm të datës 28.12.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.05.2023 ka vendosur revokimin e tij dhe shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit. Në përfundim, me vendimin nr. 00-2023-5557, datë 25.10.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Shkaku që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur revokimin e vendimit është hyrja në fuqi e ndryshimeve të reja ligjore në KPC në datën 29.05.2021, pra pas dhënies së vendimit të parë të ndërmjetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

12. Siç ka theksuar Gjykata, por edhe shumica në arsyetimin e saj, në të drejtën procedurale vepron parimi *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se efekti prapaveprues i ligjit procedural është përjashtim që vendoset nga ligjvënësi sipas kriterëve specifike, me qëllim që të mos ndikojë në mënyrë arbitrare në të drejtat tashmë të fituara nga të tretët.

13. Në këtë kuptim, duhet vënë re se, si rregull, fillimi i procesit gjyqësor gjeneron tek individit një lloj të drejte të fituar për të ruajtur të paprekura rregullat procedurale në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës. Zbatimi i këtij parimi duhet bërë sipas një *modus procedendi* të caktuar, në mënyrë që veprimtaria procedurale e kryer të mos “shqetësohet” nga rregullimet e reja, përndryshe uniteti dhe konsistenca e veprimtarisë procedurale të kryer sipas ligjit të kohës do të vihej në pikëpyetje në mënyrë të pashmangshme. E thënë ndryshe, duke qenë se procesi është një lloj procedure, pra një sekuencë e normave juridike të koordinuara për prodhimin e një akti përfundimtar, parimi në fjalë nuk mund të udhëheqë dhënien e vendimit përfundimtar, por secilin prej akteve procedurale që duhet të formësohet sipas ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së tij.

14. Në këtë këndvështrim, duke qenë se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë zhvillohet në disa faza të ndryshme, me karakteristika që dallojnë nga njëra-tjetra, vlerësojmë se ndryshimet ligjore të natyrës procedurale që miratohen gjatë procesit gjyqësor, në përmbajtje të cilave nuk ka asnjë rregull për efekte prapavepruese, mund të rregullojnë vetëm efektet e paezauruara të tij dhe nuk mund të zbatohen për marrëdhëniet tashmë të rregulluara sipas ligjit të kohës. Në vlerësimin tonë, një qëndrim i ndryshëm do të binte ndesh me parimet që mbrohen nga Kushtetuta, të tilla, si siguria juridike dhe pritshmëritë e ligjshme të individëve nga rendi juridik në tërësi, si dhe nga rregullat procedurale në veçanti, të cilat, bazuar në garancitë e procesit të rregullt ligjor, kërkojnë që gjatë zbatimit të akteve ligjore të mos lihet vend për arbitraritet. Në këtë kuptim, parimi *tempus regit processum* përjashton efektin prapaveprues të ligjit të ri dhe, për pasojë, rivlerësimin e aktit të kryer sipas ligjit të kohës nën dritën e rregullave të reja.

15. Bazuar në standardet e lartpërmendura, vlerësojmë se nëse dhoma e këshillimit e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë sipas ligjit të kohës ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs duhet të shqyrtohen në seancë gjyqësore dhe të marrin përgjigje të arsyetuar, ky vendim i ndërmjetëm nuk mund të rivlerësohet duke i dhënë fuqi prapavepruese ligjit të ri procedural.

16. Po kështu, në vlerësimin tonë, vendimet e dhomës së këshillimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore nuk mund të barazohen me vendimet e ndërmjetme procedurale, të cilat jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'u përgjigjen kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat procedurale. Kjo për arsye se vendimet e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbyllin një fazë të procedurës që zhvillohet në atë gjykatë dhe hapin një fazë tjetër procedurale, ku trupi gjyqësor ushtron kompetenca të ndryshme – ato të shqyrtimit të çështjes në themel dhe të vendimmarrjes përfundimtare për bazueshmërinë në themel të shkaqeve të rekursit.

17. Në këto kushte, vendimi i Gjykatës së Lartë shfaq probleme me natyrë kushtetuese, të cilat duhet të kishin marrë një vlerësim përfundimtar konkret edhe në themel, kjo pasi, së pari, Gjykata e Lartë ka interpretuar me efekt prapaveprues parashikimet e reja procedurale, duke zbatuar ndryshimet ligjore gjatë fazave procedurale të ndryshme të procesit ligjor dhe pasi çështja në fjalë ishte shqyrtuar tashmë në dhomën e këshillimit nga një tjetër kolegji i po asaj gjykate, i cili, pasi kishte ezauruar fazën e shqyrtimit paraprak të shkaqeve të ngritura në rekurs, kishte

vendosur kalimin e saj në seancë gjyqësore. Së dyti, Gjykata e Lartë ka vlerësuar arsyet dhe shkaqet për të cilat dhoma e këshillimit e mëparshme e asaj gjykate kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke hamendësuar dhe prezumuar për mënyrën se si ajo ka vepruar, ndërkohë që shkaqet për të cilat pranohet për shqyrtim rekursi janë përcaktuar nga dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin në Gjykatën e Lartë. Të tilla vlerësime që i përkasin shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit nuk mund t'i nënshtrohen më vlerësimit nga një trupë e ndryshme, as për arsye të ndryshimit të legjislacionit procedural që nuk parashikon efekte prapavepruese dhe as për arsye të ndryshimit të përbërjes së asaj gjykate/trupave të saj. Së treti, në kushtet kur ligji procedural që është interpretuar dhe zbatuar nga Gjykata e Lartë nuk parashikon shprehimisht të drejtën e kolegjit për të revokuar vendime të mëparshme, duhej analizuar nëse dhënia e efekteve prapavepruese të rregullave të reja procedurale përbën interpretim arbitrar të ligjit nga ajo gjykatë, në kuptim të (mos) respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës.

18. Nisur edhe nga parimet e rëndësishme që mund të cenohen nga një praktikë e tillë e Gjykatës së Lartë, sikurse jemi shprehur edhe më parë (*shih mendimin paralel në vendimin nr. 31, datë 29.05.2023 të Gjykatës*) jemi të mendimit se lidhur me këtë çështje duhej të jepej një vlerësim përfundimtar konkret dhe në themel, kjo edhe për të orientuar veprimtarinë procedurale të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në drejtim të respektimit të të drejtave kushtetuese të individit.

19. Në përfundim, vlerësojmë se kërkuesi legjitimohej në ngritjen e këtij pretendimi dhe se ankimi kushtetues individual i plotësonte kërkesat paraprake për kalimin e çështjes në seancë plenare.

Anëtare: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji